

GFI Albania sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2017**

Permbajtja:

	Faqe
Raporti i audituesit te pavarur	i-ii
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2017	1
Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	2
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	3
Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	4
Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare	5 - 23

Raporti i Audituesit të Pavarur

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasher, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.granthornton.al

Për aksionerët e GFI Albania Sh.p.k

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të GFI Albania Sh.p.k (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Bazat e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijmësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kledian Kodro, FICA
Kodro

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

31 mars 2018

GFI Albania sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shenime shpjeguese	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare	4	86,976,813	61,475,004
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	5	2,288,379	1,742,325
Inventare	6	81,924,577	89,118,244
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	7	4,127,618	20,308,158
Totali i aktiveve afatshkurtra		175,317,387	172,643,731
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	150,749,624	122,776,870
Aktive afatgjata jomateriale	9	2,807,897	3,345,611
Totali i aktiveve afatgjata		153,557,521	126,122,481
Totali i aktiveve		328,874,908	298,766,212
Pasivet dhe kapitali			
Pasivet afatshkurtra			
Detyrimet per t'u paguar dhe parapagime	10	83,836,847	81,829,805
Te ardhura te marra ne avance	11	4,816,630	6,580,479
Huamarije - pjesa afatshkurter	12	49,993,901	105,307,534
Totali i pasiveve afatshkurtra		138,647,378	193,717,818
Pasivet afatgjata			
Huamarije - pjesa afatgjate	12	142,558,444	190,478,377
Totali i pasiveve afatgjata		142,558,444	190,478,377
Kapitali aksionar			
Kapitali i nenshkruar		123,567,930	123,567,930
Humbja e mbartur		(208,997,913)	(323,727,318)
Fitim (Humbja), neto e vitit		133,099,069	114,729,405
Totali i kapitalit aksionar		47,669,086	(85,429,983)
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		328,874,908	298,766,212

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 – 23 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare te Shoqerise per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2017 u aprovuan nga administratoret dhe u nenshkruan ne date 2 mars 2018 si me poshte:

Vangjel Birbo



Dorian Deltina

GFI Albania sh.p.k.
Pasqyra e te ardhurave gjithëperfs hirese
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shenime shpjeguese	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2016
Te ardhura nga aktivitetet e markimit	13	416,629,506	386,403,300
Te ardhura te tjera		-	475,799
Totali i ardhurave		416,629,506	386,879,099
Shpenzimet			
Kosto e markerit	14	(85,397,780)	(81,236,174)
Kosto e punes:	15		
Pagat e personelit		(86,916,842)	(81,729,672)
Sigurime shoqerore dhe shendetesore		(11,321,515)	(10,908,131)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale		(17,533,674)	(7,030,987)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale		(537,714)	297,292
Tarife koncesioni	16	(10,415,737)	(9,660,081)
Shpenzime administrative	17	(51,140,511)	(68,700,723)
Totali i shpenzimeve		(263,263,773)	(258,968,476)
Fitimi (humbje) nga veprimtaria kryesore		153,365,733	127,910,623
Te ardhura financiare, neto			
Shpenzime financiare, neto	18	(11,759,231)	(20,223,131)
Humbje nga kembimi, neto	19	16,545,277	7,041,913
Totali i te ardhurave financiare, neto		4,786,046	(13,181,218)
Fimim (humbje) neto e vitit		158,151,779	114,729,405
Tatim-fitimi	20	(25,052,710)	-
Fitim (humbje) neto e vitit		133,099,069	114,729,405
Te ardhura te tjera gjithëperfs hirese:			
Te ardhura gjithëperfs hirese per vitin		-	-
Fitim/(humbje) i atribueshem per:			
Pronaret e shoqerise meme		133,005,900	114,649,094
Interesa jokontrolluese		93,169	80,311
Fitimi/(humbja) per vitin		133,099,069	114,729,405
Te ardhura/(humbje) totale te atribueshme per:			
Pronaret e shoqerise meme		133,005,900	114,649,094
Interesa jokontrolluese		93,169	80,311
Totali i te ardhurave (humbjeve) gjithëperfs hirese per vitin		133,099,069	114,729,405

Pasqyra e te ardhurave gjithëperfs hirese duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5– 23 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

GFI Albania sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

Pasqyrat e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i nenshkruar	Kalim ne fitim humbje te akumuluar	Fitim (Humbja) e periudhes	Totali
Pozicioni me 31 dhjetor 2015	123,567,930	(282,800,483)	(40,926,835)	(200,159,388)
Kalim ne fitim/humbje te akumuluar		(40,926,835)	40,926,835	-
Fitim (Humbja) e vitit	-	-	114,729,405	114,729,405
Pozicioni me 31 dhjetor 2016	123,567,930	(323,727,318)	114,729,405	(85,429,983)
Kalim ne fitim/humbje te akumuluar		114,729,405	(114,729,405)	-
Fitim (Humbja) e vitit	-	-	133,099,069	133,099,069
Pozicioni me 31 dhjetor 2017	123,567,930	(208,997,913)	133,099,069	47,669,086

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 – 23 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

GFI Albania sh.p.k.
Pasqyra e flukseve monetare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shenime shpjeguese	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2016
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitim (humbje) para tatimit		158,151,779	114,729,406
<i>Rregullime per:</i>			
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale	8	17,533,674	7,030,986
Amortizimin e aktiveve afatgjata jomateriale	9	537,714	(297,292)
Shpenzime interes		11,759,231	18,919,713
Humbje te perealizuara nga kursi i kembimit nga huate		2,310,993	483,592
Te ardhura nga interesi			(157,099)
(Rritje) ulje ne kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme		(546,054)	4,272,553
(Rritje) ulje ne inventare		7,193,667	(24,253,469)
(Rritje) ulje ne parapagime dhe shpenzime te shtyra		16,180,540	2,629,619
Rritje (ulje) ne detyrimet per t'u paguar dhe parapagime		(13,045,668)	25,922,248
Rritje ne te ardhura te marra ne avance		(1,763,849)	2,606,175
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		198,312,027	151,886,431
Tatim fitim i paguar		(9,859,996)	-
Interesi i paguar per overdraft-in		(1,352,268)	(5,650,760)
Interes i paguar per huane bankare		(7,089,836)	(12,541,177)
Interes i paguar per hua te tjera		(5,453,550)	-
Interes i paguar per leasing		(277,837)	-
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit		174,278,540	133,694,494
Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	9	(45,506,427)	(2,595,735)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale		-	-
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e investimit		(45,506,427)	(2,595,735)
Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit			
Overdraft		(57,188,485)	(43,239,579)
Hua bankare		(47,101,688)	(51,321,840)
Interesa nga ortakët		300,097	(16,947)
Hua te tjera		(23,781,618)	-
Leasing		24,501,390	-
Kontribut ne kapital		-	-
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e financimit		(103,270,304)	(94,578,366)
Pakesimi (Rritja) neto e mjeteve monetare		25,501,809	36,520,393
Mjetet monetare ne fillim te periudhes		61,475,004	24,954,610
Mjetet monetare ne fund te periudhes	5	86,976,813	61,475,004

Pasqyra e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 23 qe jane pjese perberese e pasqrave financiare.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

1. Informacion i pergjithshem

Shoqeria GFI Albania sh.p.k. (me poshte referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 5 prill 2013 dhe prane Deges se Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT L31605014G.

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet ne perputhje me dispozitat perkatese te Ligjit 9901, date 14 prill 2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte ai i percaktuar ne Kontraten Koncesionare "Per sherbimin e Markimit dhe te Monitorimit te Karburanteve", te nenshkruar me date 27 shkurt 2013 midis ortakeve te Shoqerise dhe Ministrise se Financave te Republikes se Shqiperise (me poshte referuar si "Kontrata Koncesionare"). Sipas kesaj te fundit, objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte ndertimi dhe testimi i sistemit operativ per ofrimin e sherbimit te markimit dhe monitorimit te karburanteve ne Republikën e Shqiperise, shfrytezimi i sistemit operativ, dhe transferimi i pajisjeve te sistemit operativ per monitorimin e karburanteve ne Republikën e Shqiperise tek Ministria e Financave pas perfundimit te afatit te Koncesionit. Kontrata e Koncesionit ka nje afat dhjetevjecar nga data efektive e saj.

Shoqeria zoterohet nga ortakët Petroleum Consulting Partners A.G. dhe Global Fluids International S.A., te cilet me 31 dhjetor 2017 zoterojne respektivisht 99.93% dhe 0.07% te kapitalit themeltar.

Administratoret e Shoqerise jane Z. Vangjel Birbo dhe Z. Dorian Deltina. Secili prej administratoreve ka kompetence per te perfaqesuar Shoqerine i vetem.

Selia kryesore e Shoqerise ndodhet ne Rrugen "Murat Toptani", Eurocol Business Center, kati i dyte, Tirane dhe selia dytesore ndodhet ne Autostraden Tirane-Durres, Km. 6, Kashar, Tirane.

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2017 eshte 66 (2016: 64).

Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë. Kapitali i përgjithshëm i kompanisë është në vlera negativ për të tretin vit radhazi. Duke pasur parasysh se në bazë të legjislacionit tatimor shqiptar, një kompani, kapitali i së cilës është në vlera negative për tre vjet rresht mund t'i nënshtrohet procedurave të likuidimit, shfaqen pasiguri materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar aktivitetin. Menaxhimi ka marrë konfirmimin me shkrim të mbështetjes nga ortakët Petroleum Consulting Partners A.G. dhe Global Fluids International S.A. për të marrë burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin në të ardhmen e afërt dhe beson se kjo arsye është e mjaftueshme për të përgatitur pasqyrat financiare në bazë vijimësie. Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rregullimet që do të rezultojnë në qoftë se kompania nuk do të ishte në kushtet e aktivitetit në vijimësi.

Në bazë të ligjit "Për procedurat tatimore", administrata tatimore ka të drejtë të fillojë procesin e likuidimit për ato kompani të cilat rezultojnë me total kapitali negativ për një periudhë prej të paktën tre vjet rresht.

2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave

2.1 Pajtuësmeria

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) ne fuqi ne Shqiperi.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

2.3 Periudhat krahasimore

Te dhenat e periudhave te meparshme jane riklasifikuar per t'i bere ato te krahasueshme me paraqitjen e te dhenave te periudhes ushtrimore.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Leke, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te kompanise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne vecanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente nga Shoqeria, pervec rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehin ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte.

Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare ne monedhe te huaj jane:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Euro/Lek	132.95	135.23
Usd/Lek	111.10	128.17

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe llogari te pagueshme.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, pervec siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne shpenzime dhe te ardhura. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur Shoqeria transferon aktivitet financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne depozita pa afat dhe depozita me nje afat maturimi prej tre muajsh ose me pak qe nga data fillestare.

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme (kerkesat e arketueshme) njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjoni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose pagesa te vonuara konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis vleres fillestare dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne metoden e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Inventare

Inventaret percaktohen me vleren me te vogel midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Kostoja percaktohet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera per perfitimin e inventarit dhe kosto te tjera te kryera per dergimin e inventareve ne destinacion dhe me kushtet e kerkuara. Vlera neto e realizueshme i referohet vleres neto qe Shoqeria pret te perfitoje nga shitja e inventarit, ne rrjedhen normale te biznesit, minus kostot e shitjes.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitet. Ne rastet kur pjese te nje aktivitet afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

(komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe Shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marre per baze periudhen me te shkurter midis afatit te koncesionit dhe jetes se vleresuar te dobishme te aktivitetit duke filluar nga dita kur ai eshte i gatshem per perdorim. Aktivitetet e marra me qira financiare amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat e amortizimit dhe perqindjet perkatese sipas grupeve te aktiveve afatgjata per periudhen aktuale jane si me poshte:

Ndertesa	Mbi vleren kontabel neto	10%
Permiresime ne qiramarrje	Mbi vleren kontabel neto	10%
Makineri dhe pajisje	Mbi vleren kontabel neto	20%
Mjete transporti	Mbi vleren kontabel neto	20%
Orendi dhe pajisje zyre	Mbi vleren kontabel neto	20%
Kompjutera dhe pajisje informatike	Mbi vleren kontabel neto	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi.

Brenda aktiveve afatgjata jane paraqitur edhe aktivitetet afatgjata te cilat kane lidhje me koncesionit, per shkak te natyres materiale te ketyre aktiveve dhe vleres josingjifikative ne daten e bilancit.

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitetet afatgjata jomateriale qe kane nje jete te percaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes se aktivitetit te zvogeluar me vleren e tij te mbetur. Shuma e amortizimit kalon ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne menyre zbritese pergjate jetes se aktivitetit.

Shoqeria ka vetem dy programe kompjuterike te njohura ne keto pasqyra financiare, te cilat jane amortizuar mbi vleren kontabel neto me perqindje 25%.

3.6 Zhvleresimi

Aktivitetet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktiviteti.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivitetin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase, te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivitetet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivitetet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut kreditor.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar te disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitetet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktiviteti tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Provigjonet

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.8 Njohja e te ardhurave

